



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

---

**Legjislatura V**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 33

Prishtinë, më 29.7.2015, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S 2

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Agim Aliu, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj, Donika Kadaj-Bujupi dhe Milena Miliçeviq.

**Mungoi:** Fatmir Limaj.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Tringa Bytyqi dhe Kaltrina Ahmeti – GLPS, Shefki Kastrati – NDI, Dibran Istrefi – Klan Kosova, Mirjana Marinković- RTK 2, Blerta Bejtullahu-EUSR/EU Office, Lejla Selimi - OSBE, Hamit Mjeku dhe Zahir Çerkini dhe Gentiana Dushi – praktikantë.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 3 dhe 16.06.2015;
3. Procedimi i shkresës së Nënkomisionit për Gjykatën Themelore në Prishtinë;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për Patenta;
5. Diskutimi për shpalljen e konkursit për anëtare të KGJK-së.
6. Të ndryshme.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryetarja** para miratimit të rendit të ditës theksoi se dua të përmend një çështje që këtyre ditëve ka qenë mediale, pra fjala është për propozimet nga Ministria për Komunitete dhe Kthim për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit për Ndihmë Juridike falas. Në mbledhjen e datës 27.7.2015 ne patëm shqyrtuar propozimet e institucioneve të përcaktuar me ligj për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike falas duke mos proceduar me propozimet nga Ministria për Komunitete dhe Kthim për shkak se logoja nga kjo ministri ishte në cirilik. Versioni i ngjashëm është përdorur në kohën e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, të themeluara në bazë të Kornizës Kushtetuese të hartuar nga UNMIK-u. Kjo ka bërë që këtyre ditëve të kemi deklarata të pa bazuara nga lista serbe dhe ministri Jevtiq. Andaj, si kryetare e Komisionit, edhe njëherë sqaroj se kam kërkuar nga zyra ligjore e Kuvendit që ta interpretojë nëse kjo formë (logo) është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme. Kjo pasi që si rregull në Kuvend shkresat procedohen me logo standarde dhe me shkronja latine dhe jo sikur kjo e ministrisë në cirilik. Ne, si komision, nuk e kemi kthyer pas propozimin, por vetëm e kemi hequr nga rendi i ditës për të marrë sqarime shtesë. Ajo para deputetëve paraqiti vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 18.2.2008 ku në pikën 1 thuhet ” Miratohet logoja e re e Republikës së Kosovës, me stemën dhe tekstin sipas Shtojcës I të bashkëngjitur këtij vendimi”.

Nëse e shikoni shtojcën ajo është me shkronja latin dhe jo cirilik siç ka proceduar Ministria për Komunitete dhe Kthim. Administrata e Kuvendit më ka thënë se ne nuk i interpretojmë vendimet e Qeverisë. Andaj ndoshta do të ishte mirë të kërkojmë sqarim nga Qeveria nëse ende vlen ky vendim apo jo.

**Doruntinë Maloku-** Tha se është e pa kuptimtë të kërkojmë mendim nëse është shfuqizuar vendimi përderisa ne po e dimë që është në fuqi.

**Selviqe Halimi-** Tha se vendimi është i qarë dhe është në fuqi edhe pse deri tani nuk kemi pasur probleme të kësaj natyre dhe në bazë të këtij vendimi të gjitha institucionet janë të obliguara të veprojnë sipas këtij vendimi. Kush mendon se duhet vepruar ndryshe le t'i drejtohet Qeverisë individualisht.

**Kryetarja** shtoi se është obligim i Qeverisë të reagojë në këto situata, por shihet që nuk ka pasur ndonjë reagim.

**Milena Miliqeviq** – Tha se në mbledhjen e kaluar nuk isha e sigurt për çfarë letre po bëhet fjalë për mënyrën e përdorimit të dy gjuhëve zyrtare dhe nuk kam qenë në njohuri se a ka ardhur me alfabetin cirilik apo latin. Nëse është përdorur alfabeti cirilik askush nuk e ndalon pasi që shumica e dokumenteve që dalin nga institucionet tona vendore përdorin ciriliken, po ashtu edhe ne pasaporta edhe në letërnjoftimet përdoren shkronjat e alfabetit cirilik. Kjo është arsyeja pse nuk kam reaguar në mbledhjen e kaluar dhe kërkoi që në këtë mbledhje të procedohet propozimi nga Ministria për Komunitete dhe Kthim me emër të kandidatit.

**Armend Zemaj-** Tha se gjuha shqipe dhe serbe dhe alfabetet e tyre janë të barabarta por në anën tjetër është obligim i Qeverisë të kemi një përdorim standard, dhe jo të kemi dy forma. Po ashtu, sa për të hequr dilemën në opinion këtu nuk ka të bëjë me emrat e propozuara nga Ministra për Komunitete dhe Kthim, por thjesht për procedura dhe në këtë kontekst ne edhe mund të procedojmë me emra.

**Selvije Halimi-** Vlerësoi se emrin nga kjo Ministri mundemi edhe me proceduar, por në të njëjtën kohë mund t'i drejtohem me shkresë Qeverisë, ku në një formë edhe mund ta njoftojmë se si veprohet me standarde rreth logos së Qeverisë dhe në të njëjtën kohë të kërkohet që të rishikohet vendimi. Kjo pasi që në preambulën e vendimit shihet që është thirrur në rregulloren e UNMIK-ut dhe kornizën kushtetuese për vetëqeverisjen lokale, dokumente këtë që më nuk janë në fuqi.

**Agim Ademaj-** Ishte i mendimit që duhet kërkuar sqarim nga Qeveria për këtë vendim, por vlerësoi se emrin për kandidatin duhet proceduar pasi nuk ka probleme rreth emrave të propozuar, por duke e njoftuar Qeverinë se më nuk do të procedohen shkresa të tilla.

**Agim Aliu-** Tha se nga diskutimet e parafolësve shihet që ne nuk kemi asgjë kundër gjuhës, përkatësisht alfabetit të tyre, pasi që kjo është pjesë e Kushtetutës. Ne para vetes kemi një vendim që është shumë i qartë i cili nuk është i pasuar nga ndonjë vendim tjetër. Vendimi ka përcaktuar qartë standardet e përdorimit të logos dhe duke pas parasysh se kanë qenë dy mundësi të përdorimit të alfabetit serb, atij cirilik dhe latin, është përcaktuar që të përdoret alfabeti latin. Përderisa ky vendim e ka standardizuar si formë, ky është obligim për të gjitha institucionet e Republikës që të përdoret forma standarde. Vlerësoi se vendimi duhet të respektohet dhe nuk duhet të procedohet emri, përkundër asaj se nuk jemi kundër emrave të propozuar, por duhet t'i dërgohet një shkresë Qeverisë për sqarim sepse ne nuk e dimë në të ardhmen se a do të kemi dokumente të tilla.

**Nezir Çoçaj** u pajtua me parafolësin dhe vlerësoi se nuk duhet të procedohet me asnjë lloj shkrese e cila del jashtë standardit të përcaktuar nga një institucion i Kosovës, pavarësisht emrave, dhe si komision kryesor nuk duhet të lejojë këso lloj shkeljesh.

**Donika Kadaj -Bujupi** – Theksoi se shihet që kemi një pajtim të përgjithshëm sepse jemi për atë që të mos krijojmë precedent të shkeljes së ligjeve. Shtoi se duhet t'i kërkojmë sqarim Qeverisë dhe po ashtu nuk duhet të procedojmë me emra përderisa nuk kemi një sqarim lidhur me këtë çështje.

**Milena Milqeviq - Unë** me të vërtetë nuk kam përmend asnjë emër dhe kam pyetur z. Zemaj dhe kam kuptuar se logoja ka qenë me alfabet cirilik dhe unë asnjëherë nuk kam përmendur ndonjë emër.

*Pas debatit, Komisioni vendosi që t'i drejtohet Qeverisë me një shkresë ku do të kërkohet sqarim nëse Qeveria është në dijeni për përdorimin e standardeve të dyfishta në përdorimin e logos nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, siç parashihet me vendimin e Qeverisë Nr. 11/8 i datës 18.2.2008.*

**Kryetarja-** Tha se është kërkuar që në rend dite të përfshihet edhe shqyrtimi i raportit me amendamentet në Projektligjin nr. 05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për Markat Tregtare.

*Komisioni nuk e përkrahu propozimin që në rend dite të përfshihet shqyrtimi i raportit me amendamentet në Projektligjin nr. 05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për Markat Tregtare.*

## **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 3 dhe 16.06.2015**

*Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 3 dhe 16.06.2015, pa vërejtje.*

## **3. Procedimi i shkresës së Nënkomisionit për Gjykatën Themelore në Prishtinë**

**Kryetarja-** Tha se kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar por që nuk kemi pasur kuorum për ta votuar. Ajo tha se diskutimet për këtë çështje kanë përfunduar dhe kërkoj nga anëtarët që të deklarohen nëse janë për procedimin e përgjigjes siç e ka përgatitur Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit.

*Komisioni me 7 vota “për”, 1 “kundër dhe 2 “abstenime”, vendosi që t’i procedohet përgjigja Gjykatës Themelore në Prishtinë, e përgatitur nga Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit, pa asnjë ndryshim.*

## **4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për Patenta**

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për Patenta dhe kërkoj nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërtetje.

*Meqë nuk kishte vërejtje, Kryetarja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:*

### **Rekomandim**

1. Projektligji nr. 05/L-039 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për Patenta dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t’i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

## **5. Diskutimi për shpalljen e konkursit për anëtarë të KGJK-së**

**Kryetarja** i njoftoi anëtarët se me ndryshimet e reja në ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, zgjedhja e anëtarëve nga Kuvendi do të jetë me konkurs. Janë dy vende që duhet plotësohen 1 (një) anëtar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, pika 2 e

Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe 1 (një) anëtar për përfaqësuesit e komunitetit serb në Kosovë, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ishte e mendimit se duhet formohet një grup punues që do të caktojë kriteret e konkursit.

*Pas diskutimeve, Komisioni vendosi që të formojë një grup punues të cilin do ta kryesojë Albulena Haxhiu, dhe anëtar të jenë nga një përfaqësues nga secili grup parlamentar.*

## **6. Të ndryshme**

Në këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

---

**Albulena Haxhiu**